

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Orientalistikë
Titulli i lëndës:	Gjuhë perse 2
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Fakulteti i Filologjisë/ UP Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Abdullah hamiti
Detajet kontaktuese:	abdullahamiti@yahoo.com
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Lënda <i>Gjuhën perse II</i> vazhdon materia me njësitë nga Morfologjia e gjuhës perse (kategoritë e ndryshme të sistemit foljor). Pastaj kalohet tek sintaksa e gjuhës perse; struktura gramatikore e fjalisë me gjymtyrët e saj subjektin, predikatin, me objektin direkt dhe indirekt dhe me gjymtyrët e tjera të fjalisë. Analiza sintaktike-semantike e fjalive të përbëra, respektivisht analiza e fjalive të përbëra me marrëdhënie bashkërenditëse dhe me marrëdhënie nënrenditëse. Nga fjalitë e përbëra me marrëdhënie bashkërenditëse veçmas do të trajtohen: fjalitë e përbëra lidhëzore (kopulative), veçuse (disjunctive) dhe kundërshtore (adversative). Fjalitë e përbëra me marrëdhënie nënrenditëse, si fjalia e përbërë me marrëdhënie nënrenditëse me ndërtim objector; fjalitë e përbëra me marrëdhënie nënrenditëse me ndërtim adverbial; si edhe fjalitë e përbëra me marrëdhënie nënrenditëse me ndërtim atributiv, fjalia lidhore (relative).</p> <p>Ushtrimet me përmbajtje i përcjellin ligjeratat, e nga studentët kërkohet të bëjnë analizën sintaksore të fjalive si dhe t'i përcaktojnë llojet e tyre.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky kurs ka për qëllim që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'u ofroj studentëve njohuri për rregullat sintaksore të gjuhës perse. Sintaksa e fjalisë. - t'i dallojnë dhe t'i përdorin drejtë gjymtyrët e fjalisë (kryefjalë, kallëzues, object e plotësat) në fjalinë e gjuhës perse. - të thellojnë njohuritë dhe shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde perse.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të duhej të jetë në gjendje që:

	<ul style="list-style-type: none"> - të zotnojë sistemin foljor të gjuhës perse; - të nxë rregullat për krijimin e fjalive në gjuhën perse – topika e fjalisë. - t’i dallojë gjymtyrët e fjalisë dhe të di t’i përdor drejtë gjymtyrët e fjalisë në fjalinë e gjuhës perse. - të kuptoj ndryshimin e strukturës së fjalisë në gjuhën perse dhe në ate shqipe. - të aftësohet për komunikim përkatës në situata të ndryshme, të zhvillojë biseda e të përkthej nga persishtja në shqipe dhe anasjelltas. - t’i identifikoj problemet e të nxënit të sintaksës së fjalisë së gjuhës perse. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			105
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Mësimi është mësim i rregullt me formën e ligjeratave 2 orë në javë dhe poashtu përcillet me punë praktike gjatë ushtrimeve 2 orë në javë. Ushtrimet me studentë ku do të ketë diskutime e dialogje dhe përkthime nga të dy gjuhët persishtshqip dhe anasjelltas zhvillohen në grup e pastaj kalohet edhe në punë individuale që do të bëhet kryesisht jashtë ambienteve të fakultetit (shtëpi, bibliotekë).</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Do të zbatohen këto metoda të vlerësimit: Vlerësimi i parë: 15%</p>		

	Vlerësimi i dytë: 15%
	Angazhimet e tjera 15%
	Vijimi i rregullt 5%
	Provimi final: 50%
	Totali 100%
Literatura	
Literatura bazë:	<i>Sikiric, Šacir (Dr.), Gramatika perziskog jezika, Sarajevo, 1952;</i> <i>Alavi, Bozorg & Lorenz, Manfred: Lehrbuch der persischen Sprache, Leipzig, 1974.</i> <i>AZFA 1,2,3, doracak për mësimin e gjuhës perse.</i>
Literatura shtesë:	<i>Dr. Seyed Ali Asghari, ..., Fjalor Persisht – Shqip, Fondacioni Shirazi, Tiranë, 2010</i>
Plani i dizajnuar i mësimin:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kohët e thjeshta të foljeve: e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja
Java e dytë:	Kohët e përbëra të foljeve: Imperfekti, Pluskuamperfekti, Prfezenti II
Java e tretë:	Mënyrat e foljeve të gjuhës perse
Java e katërt:	Foljet kauzative dhe foljet e përbëra
Java e pestë:	Gjerundet dhe participet e gjuhës perse
Java e gjashtë:	Parafjalët, ndajfoljet dhe lidhëzat
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë intermediar.
Java e tetë:	Fjalitë e thjeshtë, pozita e subjektit, predikati dhe pozita e tij dhe përshtatja e predikatit me subjektin
Java e nëntë:	Llojet e fjalive të thjeshta: fjalia deklarative, fjalia pyetëse, fjalia dëshirore, fjalia urdhërore
Java e dhjetë:	Fjalitë e përbëra: a) Fjalitë e përbëra të pavarura
Java e njëmbëdhjetë:	Fjalitë e përbëra: b) Fjalitë e përbëra të varura dhe llojet e tyre; Leximi i teksteve duke i analizuar fjalitë e përbëra të varura.
Java e dymbëdhjetë:	Fjalitë adverbial dhe llojet e tyre; Leximi dhe përkthimi i teksteve duke i analizuar fjalitë e përbëra adverbial në përjashtë me ato të shqipes.
Java e trembëdhjetë:	Fjalitë kushtore; lexim dhe përkthim
Java e katërmëdhjetë:	Përgaditja për test. Zgjedhja e testeve provuese.
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.	
Vijimi në ligjërata dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimin duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjiarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.	